




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/12/2022 miratoi këtë :

V E N D I M


Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 29.11.2022

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .



Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republik of Kosovo

Skupstina opštine štrpce

Kuvendi i Komunës së Shtërpçës

Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e pestë e rregullt e KK-ës të mbajtur më 29.11.2022, me fillim në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca paraprake e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës;
3. Plotësim i vendimit për formimin e Komitetit Komunal për Siguri në Komunitet
4. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit
5. Të ndryshme.

Seanca e nëntë e rregullt e KK të Shtërpçës filloi me konstatimin e kryetarit të Kuvendit, z. Predrag Grbiq se të pranishëm janë të 15 këshilltarët dhe pastaj filluam me pikën e parë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës nga seanca e kaluar KK-ës së Shtërpçës, ku askush nuk foli dhe kjo pikë u miratua unanimisht.

Pika tjetër ishte

Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK-ës së Shtërpçës, ku askush nuk kishte vërejtje, kështu që procesverbali u miratua njëzëri.

Pika e tretë ishte:

Plotësim i vendimit për formimin e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku z. Gerbic ka shpjeguar se një vend nën numrin 6 në Komitet për Siguri është i rezervuar për nënkryetarin për komunitete dhe duke marrë parasysh faktin se nënkryetari i komunës është zgjedhur në seancën e kaluar, z. Fikri Hasani, ky vend në këtë Komitet i takon sepse është në përputhje me ligjin, ka përfunduar z. Grbic.

Kjo pikë u miratua me 14 vota pro dhe 1 kundër

Pika tjetër ishte:

Formimi i komisionit për përgatitjen e planit të punës së Kuvendit, fjalën e mori kryetari i Kuvendit, i cili theksoi se nuk do të ndryshojë asgjë në krahasim me vitin e kaluar kur bëhet fjalë për përbërjen e këtij komisioni dhe se anëtarët ishin të gjithë drejtorët e Drejtorive, si dhe anëtarët e Kuvendit: Shpejtim Arifi, Sonja Kuzmanovic, Miroslav Stanojevic, Shukrije Dervishi dhe Predrag Gërbiq, si kryetar i Kuvendit. Ai tha se kjo është bërë praktikë sepse komisionet me të njëjtën përbërje tashmë kanë një përvojë me këtë çështje, dhe më pas z. Grbic propozoi që kjo përbërje të jetë komisioni për përgatitjen e planit të punës së Kuvendit.

Ky propozim u miratua me 14 vota pro dhe 1 abstenim

Pika tjetër ishte:

Të ndryshme

Z. Valjmir Ahmeti, i cili folur për shqetësimet e banorëve të vendbanimit “Gusha”, ku tha se para një muaji kanë dorëzuar kërkesë me shkrim në komunë për rrëshqitjen e dheut dhe kërkojnë që komuna të reagojë për atë çështje. Kjo rrugë normalisht përdoret nga nxënësit dhe është pothuajse e pakalueshme në dimër dhe ka dashur që dikush të dalë në terren për të vërtetuar si është gjendje faktike.

Më pas fjalën e mori **z. Shpejtim Arifi**, i cili bëri një pyetje lidhur me ngrohjen, për dru sepse shkolla Anton Santori ende nuk është furnizuar me dru dhe jo vetëm kaq por edhe disa të tjera dhe ka dashur të dijë se çfarë ka ndodhur me kontratën. Ai theksoi se kjo duhet të zgjidhet sa më shpejt që nxënësit të mos mbeten pa ngrohje.

Kryetari i Komunës, z. Dalibor Jevtic e mori fjalën, për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, i cili tha se i njeh të dy problemet dhe se do të reagojë sipas mundësive që ka komuna. Sa i përket rrëshqitjes së dheut, ai ka theksuar se problem ka edhe në vende të tjera, që ka ndodhur pas reshjeve të shumta dhe se do të reagojnë sipas procedurave dhe mundësive. E sa i përket problemit me furnizimin me dru, tha se procedurat kanë përfunduar me kohë dhe se kompania fituese e tenderit është tërhequr për shkak se çmimet po ndryshojnë dhe nuk kanë dashur të nënshkruajnë kontratën me çmimet që kanë dhënë, dhe se problemi nuk është të komuna e Shtërpcës. Ai po ashtu ka theksuar se shpreson që procedura të përfundojë sa më shpejt, sepse është alarmante që shkollat nuk kanë dru zjarri dhe po fillojnë ditët e ftohta. Ai po ashtu ka theksuar se do të kontaktojë institucionet kompetente dhe çdo gjë tjetër që është e nevojshme që nxënësit të kenë kushte të mira pune.

Më pas kryetari i komunës foli, i cili iu referua vitit pas tyre si të zgjedhur, sepse u bë një vit që ata kanë marrë detyrën, si këshilltarë dhe si vetë kryetar i komunës. Ajo që ai theksoi në fillim është se komuna që nga fillimi është përballur me sfida të shumta, të cilat kanë ndikim në punën e kryesisë komunale, ai para së gjithash ka menduar për ato ngjarje që kanë ndoll, duke filluar nga 21 dhjetori dhe periudha më pas, ku ka pasur edhe sfida politike, të sigurisë dhe financiare që sigurisht kanë prekur edhe neve, dhe po të mos ishin të gjitha këto, kryesia komunale do të kishte bërë shumë më tepër. Ajo që ai po ashtu theksoi, e që ka ndikuar edhe negativisht në punë, është qëndrimi i keq i pushtetit qendror ndaj komunës së Shtërpcës, të cilin e ka theksuar në disa

raste në periudhat e kaluara, sepse Qeveria e Kosovës as që ka ndërmarrë asgjë që është në juridiksionin e saj ligjor kur është fjala për atë marrëdhënie me komunën tonë. Ai vazhdoi duke dhënë një nga shembujt e asaj që ka theksuar më herët, ku ka përmendur kompaninë komunale që ende nuk ka licencë, edhe pse nuk ka asnjë pengesë ligjore, po ashtu Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj disa letrave të dërguara nga ana e komunës dhe kjo ka bërë që komuna të vonohet në disa procese. Ai tha se gjithçka që ka ndodhur në nivelin e lartë politik ka ndikuar edhe në punën tonë. Ai më tej theksoi se si kryetar komune do të mundohet që këto marrëdhënie politike të nivelit të lartë të mos kenë ndikim në marrëdhëniet në nivel lokal, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, tha se ka pasur një nivel të mirë bashkëpunimit dhe se kështu duhet të mbetet dhe të mos lejojmë që të na ndikojnë këto marrëdhënie politike. Në aspektin ekonomik, ai theksoi se nuk kemi pasur mbështetje nga Qeveria, përveç projektit të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Nga ana tjetër, buxheti është trajtuar ashtu siç është bërë prej vitesh, është shpërndarë në të njëjtën mënyrë si në periudhën e kaluar, 30% për komunitetin shqiptar dhe 70% për komunitetin serb, dhe do të të jetë e njëjtë në të ardhmen. Ai në fund theksoi atë që theksoi në fillim, se gjithçka që ka ndodhur në periudhën e kaluar ka ndikuar negativisht në komunë dhe personalisht e ka konsideruar se procesi që po zhvillohet ndaj ish-kryetarit dhe kolegëve tanë të tjerë është procesi politik dhe konfirmimi i kësaj është se ata janë ende në paraburgim dhe se ende nuk kanë aktakuzë dhe sigurisht që janë shkelur shumë procedura ligjore, madje edhe të drejtat e tyre njerëzore, dhe ai ishte i mendimit se këtë do ta tregojë koha. Dikush që është zgjedhur kryetar komune për tre mandate është më se e mjaftueshme se sa mbështetje ka nga qytetarët dhe se kjo është diçka që duhet të respektohet në çdo kohë, theksoi kryetari. Ai po ashtu tha se në vitin paraprak ka pasur një pasqyrë më të mirë në disa gjëra dhe ka lënë të kuptohet se do të ketë shumë ndryshime në vitin e ardhshëm, për arsye se komuna do të jetë më efikase, ku kemi të disa pozita më shumë njerëzit që duhet të kryejnë detyra të caktuara, sepse nëse duam të jemi më të mirë, duhet të fillojmë fillimisht nga vetja dhe se çdo rekomandim dhe kritikë që vjen nga qytetarët do të pranohet, nëse ajo kritikë është në vendin e duhur dhe menaxhimi i Komunës garanton se ne duhet të bëjmë punën tonë, tha kryetari i komunës. Ai falënderoi këshilltarët për punën e tyre në vitin që kaloi dhe tha se puna e tyre ka qenë në nivel të mirë, theksoi në fund kryetari.

Kryetari i Kuvendit pastaj e përmbylli seancën e nëntë të rregullt.

Procesmbajtësi

Staja Markovic



Kryesuesi i K.K.

Predrag Grbic